

## SHOQERIA \_DURRES CONTAINER TERMINAL\_ SH.A.

### SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE TE MBYLLUR ME 31.12.2019

#### I . KUADRI KONTABEL I APLIKUAR

Ne pergatitjen dhe paraqitjen e ketyre pasqyrave financiare eshte aplikuar kuadri kontabel i parashikuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, te shpallura nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit.

#### **Pershkrimi i politikave kryesore kontabel te perdorura**

Aktivi, pasivi dhe pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve jane redaktuar ne baze te parimeve kontabile sic jane parimi i kujdesit, parimi i krahasueshmerise dhe parimi i kopetences.

Gjithashtu eshte zbatuar parimi i pergjitheshem i vijueshmerise ne aplikimin e kriterëve te vleresimit dhe te paraqitjes se zerave te vecante te pasqyrave financiare. Ne bilancin prezent, jane paraqitur edhe shumet e zerave korespondues te vitit ushtrimor 2019 te klasifikuar sipas rregullave te parashikuara ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, me qellim qe ti bejme ato plotesisht te krahasueshem me ato te vitit ushtrimor 2018.

Ne vecanti per zerat e ndryshem te Pasqyrave Financiare jane zbatuar keto politika kontabile:

#### **Aktivet afatgjata te patrupezuara**

Aktivet afatgjata te patrupezuara jane paraqitur me koston e tyre historike te paksuar me amortizimin e akumuluar. Per amortizimin e tyre eshte perdorur metoda e amortizimit linear duke perdorur si baze te amortizimit vleren e tyre fillestare. Normat e amortizimit jane te njejta me ato te vitit te meparshem ushtrimor.

#### **Aktivet afatgjata te trupezuara**

Aktivet afatgjata te trupezuara jane paraqitur me koston e tyre historike te paksuar me amortizimin e akumuluar. Per amortizimin e Aktiveve Afatgjata Materiale eshte perdorur metoda e amortizimit e vleres se mbetur duke perdorur si baze te amortizimit vleren e tyre te mbetur mbas zbritjes se amortizimit te akumuluar.

Keto aktive jane ekspozuar ne bilanc te klasifikuara sipas natyres se tyre ne kategori homogjene dhe ne mbeshtetje te parimit te materialitetit. Normat e amortizimit jane te njejta me ato te vitit te meparshem ushtrimor.

Normat kontabile te perdorura per aktivet afatgjata jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 5.

## **Inventari**

Inventari eshte paraqitur me me vleren me te vogel ndermjet kosos se tyre te blerjes apo prodhimit te llogaritur sipas metodes FIFO, dhe vleres se mundesheme te realizimit te nxjerre nga cmimet e tregut.  
Normat kontabile te perdorura per inventarin jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 4.

## **Kerkesat per arketim**

Kerkesat per arketim jane paraqitur me koston e tyre te amortizuar, qe presupozon vleren fillestare te tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale te akumuluar si dhe minus zvogelimet nga renia ne vlere e mundesise per ti arketuar.  
Normat kontabile te perdorura per inventarin jane ne perputhje te plote me Standartin Kombetar te Kontabilitetit nr 3.

## **Mjetet monetare**

Mjetet monetare jane paraqitur me shumen e tyre efektive.

## **Shpenzimet e shtyra dhe te ardhura te shtyra**

Shpenzimet e shtyra dhe te ardhura te shtyra jane vleresuar dhe paraqitur ne baze te parimit te kopetences apo te ndarjes se periudhave

## **Detyrimet**

Detyrimet jane paraqitur me koston e tyre te amortizuar, qe presupozon vleren fillestare te tyre minus shlyerjet, minus amortizimet eventuale te akumuluar.

## **Kriteret e konvertimit te vlerave te shprehura ne valute te huaj.**

Te drejtat, detyrimet si dhe gjendja e monedhes ne fund te vitit eshte vleresuar duke u konvertuar me kursin e kembimit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne fund te vitit.

## **Zerat e Pasqyres te te ardhurave dhe shpenzimeve**

Postet e pasqyres te te ardhurave dhe shpenzimeve jane paraqitur dhe vleresuar ne perputhje me parimin e kujdesit dhe te kopetences te parashikuara keto ne SKK.

## **II. INFORMACIONE TE TJERA**

### **Aktivet afatgjata te patrupezuara.**

Shoqeria nuk ka aktive afatgjata te patrupezuara.

### **Aktive Financiare Afatgjata:**

Depozite bankare mbi 1 vit : 4 000 000 Lek  
Huadhenie afatgjate mbi 1 vit : 435 957 403 Lek

### **Aktivet afatgjata te trupezuara**

Dinamika e aktiveve te qendrueshme te trupezuara paraqitet keshtu:

Pershkrimi	Makineri & paisje Llog.213	Mjete Transporti Llog.215	Mobileje & pasije zyra Llog.2181	Paisje informatike Llog.2182	Paisje te tjera per zyra Llog.2188
Kostua historike	1,033,612,130	64,503,834	1,898,175	77,949,906	3,476,446
Rivleresime te mepareshme	0	0	0	0	0
<b>Teprica ne fillim</b>	<b>1,033,612,130</b>	<b>64,503,834</b>	<b>1,898,175</b>	<b>77,949,906</b>	<b>3,476,446</b>
Blere dhe krijuar	11,466,320	2,801,798	318,750	7,897,304	189,502
Riklasifikime	0	0	0	0	0
Shitje	0	-12,674,309	0	0	0
Nxjerrje jashte perdorimi	0	0	-7,083	-1,573,493	-778,255
<b>Teprica ne fund (me vlere fillestare)</b>	<b>1,045,078,450</b>	<b>54,631,323</b>	<b>2,209,842</b>	<b>84,273,717</b>	<b>2,887,693</b>

Shoqeria ka llogaritur amortizimin e ketyre aktiveve me keto norma, sipas vendimit te administrimit, duke zbatuar te njejtat norma ne % si ne vitet e meparshme ushtrimor.

Aktive Afatgjata materiale	Norma e amortizimit ne %	Metoda e llogaritjes
Vincat Portual levizes	5%	Mbi vleren e mbetur
Makineri e paisje	20%	
Mjete transporti	20%	
Mobilje dhe orendi etj	20%	
Paisje informatike	25%	

Shpenzimet e amortizimit jane brenda normave fiskale dhe jane totalisht te njohura. Amortizimi i akumuluar dhe ai i vitit ushtrimor paraqitet ne pasqyren e meposhteme:



Nr	Pershkrimi	Llog.213	Llog.215	Llog.2181	Llog.2182	Llog.2188
1	Vlera bruto	1,045,078,450	54,631,323	2,209,842	84,273,717	2,887,693
2	Amortizimi ne fillim	-287,426,814	-33,103,770	-1,277,553	-46,757,596	-1,730,881
3	Amortizimi aktiveve te dala	0	6,994,425	5,289	1,069,491	454,436
4	Amortizimi i vitit ushtrimor	-61,804,103	-5,624,224	-171,937	-9,014,171	-364,024
5	Amortizimi ne fund	-349,230,917	-31,733,569	-1,444,201	-54,702,276	-1,640,469
6	<b>Vlera neto</b>	<b>695,847,533</b>	<b>22,897,754</b>	<b>765,641</b>	<b>29,571,441</b>	<b>1,247,224</b>

Ne fund te vitit shoqeria ka hartuar inventarin kontabel dhe fizik te mjeteve ku ato jane vleresuar me koston e tyre historike.

**Parapagime per Aktive afatgjata te porsitura: 85 239 000 Lek**

## Inventari

Gjendjet e inventarit paraqitet ne kete table.

Nr	Pershkrimi	Vlera ne fillim	Ndryshimi	Vlera ne fund
1	Lende te para/	99,988,460	- 7,899,030	92,089,430
2	Prodhimi ne proces	0	0	0
3	Produkte te gateshme	0	0	0
4	Mallra per rishitje	0	0	0
5	Parapagesa per furnizime	0	0	0
6	Gjithesejt	99,988,460	- 7,899,030	92,089,430

Inventari eshte vleresuar me metoden FIFO. Gjithashtu eshte bere krahasimi i koston se blerjes me vleren e mundesheme te realizueshme.  
Informacione te tjera per inventarin:

1. Vlera e inventarit e njohur si shpenzim gjate periudhes 160,429,177 leke

Shoqeria gjate vitit ka bere inventarizimin fizik te stokut si dhe sistemimin e diferencave qe kane rezultuar.

## Aktive te tjera financiare afatshkurta

Keto aktive perbehen nga zerat e meposhtem

1. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfytëzimit	101,275,746 lekë
Nga këto : Klientë në më pak se 1 vit	101,275,746 lekë
2. Te drejta te arketueshme te tjera:	18,166,122 leke
Nga keto :	
Tatim mbi fitimin i mbipaguar per vitin 2019	189,368 leke
TVSH e kreditueshme	16,972,729 leke
TVSH e mpipaguar ne dogane	14 284 leke
Te tjera te arketueshme	989,741 leke

Kliente te paarketuar ne fillim	98,337,699 leke
Faturime gjate ushtrimit	1,322,518,564 leke
Arketime gjate vitit 2019	- 1,317,987,488 leke
Kompesim detyrimi klinete /frunitore	- 1,576,615 leke
Cvlersime te kaluar ne humbje& dif.kembim	- 16,414 leke
Kliente te paarketuar ne fund	101,275,746 leke

**Shtesa ose paksimi ( i te drejtave te arketueshme nga aktiviteti/ klientet** **2 938 047 leke**

## Aktivitet monetare

Gjendja e aktiveve monetare sipas bilancit paraqitet:

1. Depozita ne banke	42,985,361 leke
2. Depozita ne arke	240,483 leke
<b>Gjithesej</b>	<b>43,225,844 leke</b>

Gjendja e llogarive bankare eshte e argumentuar me ekstaktet e leshuara nga bankat per daten 31.12.2019 ndersa gjendja e arkes eshte e barabarte me librin e arkes date 31.12.2019.

**Shpenzime te shtyra** ne vlere 2,050,746 lek perbehen nga shpenzime per tu shperndare ne vitin ushtrimor 2020.

## Pasivet afatshkurta

Shoqeria nuk ka kredi afatshkurta te marra.

**Detyrimet afatshkurta paraqiten ne bilanc me shumen 42,703,540 leke.**

Peshen me te madhe ne kete shume e mbajne detyrimet ndaj firmave si me poshte:

1. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit : **27,726,201 leke**

1. Autoriteti Portual Durres	25,264,442 leke
2. Kurum International	403,385 leke
3. Fjona 2006 shpk	180,300 leke
4. Balkan Trans	172,305 leke
5. Furnitore te tjere	272,925leke
6. Furnitore per fatura te pamberritur	1,432,844 leke

2. Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit **2,033,877 lek**

Detyrime te tjera perbehet si vijon:

Te pagueshme ndaj Punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore:

1. Punonjesit paga per tu paguar	6,263,632 leke
2. Kontributi sig shoqerore	2,096,788 leke
3. Personeli- detyrime per tu paguar	17,000 leke

**Shuma** **8,377,420 leke**

Te pagueshme per detyrimet tatimore analizohen si vijon:

1. Tatim mbi te ardhurat personale	2,280,448leke
2. Tatimi ne burim	43,314 leke

**Shuma** **2,323,762 leke**

Te pagueshme Tarifa 2% per Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise per muajin Dhjetor 2019 **2,242,280lek**

### **Pasivet afatgjata**

Ne pasivet afatgjata futen kredite e marre nga shoqeria. Shoqeria nuk ka kredi afatgjata.

### **Perberja e kapitaleve te veta**

Struktura dhe ndryshimi i kapitaleve te veta gjate periudhes ushtrimore paraqitet ne bilanc sipas kesaj pasqyre:



Zerat e kapitaleve te veta	Gjendja ne fillim	Shtesat	Paksimet	Gjendja ne fund
<b>Kapitali nenshkruar</b>	<b>1,016,000,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,016,000,000</b>
Rezervat ligjore	40,993,330	2,122,079	0	43,115,409
Rezervat statutore	0	0	0	0
Rezervat tjera	67,405,791	0	-67,405,791	0
Fitimet e pashperndara	425,241,584	0	-425,241,584	0
Fitimet e ushtrimit		428,689,354	0	428,689,354
<b>Totali</b>	<b>1,549,640,705</b>	<b>430,811,433</b>	<b>-492,647,375</b>	<b>1,487,804,763</b>

### Diferencat e konvertimit te monedhave ne valute te huaj

Veprimet me monedhe te huaj jane konvertuar me kursin e dates se kryerjes se transaksionit. Tepricat e zerave monetare ne bilanc jane konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit. Diferencat e rrjedhura jane njohur si shpenzim apo e ardhur e periudhes. Per zerat jomonetare nuk eshte bere konvertimi por jane vleresuar me koston e tyre historike, (kursi i kembimit i dates se transaksionit).

### Gabime materiale te periudhave te mepareshme

Ne pasqyrat financiare prezente nuk ka efekte te korigjimit te gabimeve materiale te periudhave te mepareshme.

### Ngjarjet pas dates se bilancit

Me vendimin e gjykates Administrative te Apelit Tirane eshte vendosur prishja e kontrates se koncensionit. Mbas kesaj nga ana e zyres permbarimore eshte bere egzekutimi i vendimit te gjykates. Ne keto kushte ne muajin shkurt 2020 shoqeria ka nderprere aktivitetin e saj dhe ka filluar ceshtjen gjyqesore. Nga ana e avokateve te shoqerise eshte dhene opinioni se mundesia e fitimit te ceshtjes eshte mbi 50%. Ne pasqyrat financiare prezent nuk eshte regjistruar ndonje efekt financiar qe vjen nga vleresimi i ketyre ngjarjeve te ndodhura pas dates se mbylles se bilancit.

### Parimi i vijimesise

Ne keto pasqyra financiare eshte vleresuar situata lidhur me ngjarjet pas dates se bilancit te pershkruara ne paragrafin e meparshem. Ne vleresimin e drejtimet te shoqerise ky fakt nuk eshte evidentuar si nje faktor qe mund te paraqese pasiguri lidhur me vazhdimesine e veprimtarise se njesise ekonomike raportuese.

## REZULTATI FINANCIAR

Shoqeria gjate ushtrimit 2019 ka rezultuar me nje fitim bruto prej 430,514,935 leke e cila paraqitet si me poshte :

Te ardhura te ushtrimit	1,303,340,627leke
Shpenzime te ushtrimit	- 795,054,519 leke
<b>Fitimi bruto para tatimit</b>	<b>508,286,108 leke</b>
Shpenzime te panjohura	10,188,377 leke
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>518,474,484 leke</b>
Norma e Tatim fitimit	15%
Tatim fitimi	- 77,771,173 leke
<b>Fitimi neto i vitit</b>	<b>430,514,935 leke</b>

- Te ardhura e paraqitura ne postin "shitje neto" te pasqyres te te ardhurave e shpenzimeve, te cilet perputhen me deklarimin e shitjeve ne FDP, viti 2019, jane :

1. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	1,259,043,111 leke
2. Te ardhura nga aktivite te tjera	25,878,548 leke
3. Te ardhura nga shitje AQT	6,197,305 leke
<b>TOTALI</b>	<b>1,291,118,964 leke</b>

- Te ardhura te tjera/ rimarrje nga gjyget 1,361,045 lek
- Te ardhura nga veprimtaria financiare 10,860,618 lek

Te ardhurat financiare perbehen;	
1. Te ardhura nga interesa	3,166,354 leke
2. Diferenca kembimi pozitive	7,694,264 leke

Shpenzimet financiare jane 6,309,575 lek perbehen nga keto komponente	
1. Shpenzime per interesa	- 41,948 leke
2. Diferenca kembim negative	- 6,267,627 leke

**Numuri i te punesuarve:**



Kategoria	Gjendja ne fillim	Pranime	Largime	Gjendja ne fund
Punetore	75	16	6	85
Nepunes	3	2	1	4
Drejtues	2	2	1	3
Totali	80	20	9	92

Hartoi:

Alba Minia



Durres, 31.01. 2020

Administratore

Ada Kallçaku


